



Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më 19/09/2024

**DREJTUAR PËR PUBLIKIM: AGJENSISË SË PROKURIMIT PUBLIK - TIRANË**

**LËNDA: FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT (PARAPRAK)**

**DREJTUAR FITUESIT:** Operatorit Ekonomik “**EL-POWER**” shpk me *Numër NIPT: L12009008K* dhe me adresë: Tiranë Nr. Pas. 1/220+2-53, ZK nr. 8360, Bulevardi Zogu i Parë, Ndërtesa Nr.6, SH/K 2, Ap.53.

Procedura e prokurimit/lotit: “Procedure e Hapur - Mallra mbi kufirin e lartë monetar”.

Numri i procedurës/referenca **NR. REF-15378-08-05-2024** me objekt: “**Blerje paisje për nyjet komutuese të Linjave dhe N/Stacioneve**” me fond limit në vlerë: **279,960,000.00 (Dyqind e shtatëdhjetë e nëntë milion e nëntëqindë e gjashtëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.**

**In Eur: - 2,787,613.26 Euro (Two million seven hundred eighty seven thousand six hundred thirteen point twenty six) Euro Without VAT.**

Me afat 8 (Tetë) muaj nga lidhja e kontratës.

Buletini i Njoftimeve Publike: Nr. 47 datë 12.08.2024.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1.Operatori Ekonomik: “**EL-POWER**” shpk me Nr. Nipti **L12009008K.**

Vlera **271,366,000.00 (Dyqindë e shtatëdhjetë e një milion e treqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë pikë zero) lekë pa TVSH.**



**2. OE: “NOVAMAT” shpk me Nr. Nipti K81615002O.**

Vlera 278,802.000.00 (Dyqindë e shtatëdhjetë e tetë milion e tetëqindë e dy mijë pikë zero) lekë pa TVSH.

Nga pjesmarrësit është skualifikuar Ofertuesi i mëposhtëm:

**OE: “NOVAMAT” shpk me Nr. Nipti K81615002O.**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ofertës të paraqitur nga **OE: “NOVAMAT” shpk me Nr. Nipti K81615002O** referuar kritereve të përzgjedhjes/kualifikimit Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi si më poshtë vijon:

**1. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se dyfishi i vlerës së përlllogaritur të fondit limit prej 559,920,000 All nuk përmbushet nga OE: NOVAMAT sipas vërtetimit të xhiros vjetore të paraqitur.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP i ndryshuar, si dhe nenin 43, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Duke marrë ne konsiderate specifiken e mallrave objekt procedure prokurimi, kërkohet që OE ofertues te paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë ne kohe dhe ne përputhje me specifikimet teknike te kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet te ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qellim, eshte argumentuar se vlera e xhiros për tre vitet e fundit financiare te jete jo më e vogël se dyfishi i vlerës së përlllogaritur të fondit limit.

**2.3.4** Operatori ekonomik duhet te paraqese certifikatat te cilat verifikojne qe releja e mbrojtjes dhe kontrollit eshte ne perputhje me te gjitha standardet EN 60255-26:2013, EN 60255-27:2014, IEC 62439-3:2016 për protokollat PPR dhe HSR, IEC 61850-6,7-1 ,7-2,7-3,7-4,8-1 niveli A, standardi IEEE C37.238TM02017 dhe DNP 3.0 ose ekuivalente me to. AK do pranojë edhe mundësinë e paraqitjes së standardeve shqiptare SSH mbi komformitetin e standardit europian dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë **SSH IEC SSH EN**.

**Nuk është paraqitur asnjë dokument për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri.**



**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenit 40 pika 6 gërma (c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ndryshuar. Në përmbushje të kriterit të mësipërm Operatorët Ekonomike, duhet të paraqesin dëshmi të testimeve zyrtare të ngjashme për ti krijuar bindjen AK se malli i ofruar është brenda parametrave të kërkuara.

**2.3.5** Operatori ekonomik duhet të paraqesë raportet e testimit që verifikojnë që releja e mbrojtjes dhe e kontrollit është në përputhje me të gjitha standardet EMC dhe LVD, direktivat EMC 2014/30/EU, Direktiva e Tensionit të Ulët 2014/35/EU, EN 60255-26: 2013, CISPR 11: 2015, CISPR 22:2008, EN 60255-27:2014, IEC 62439-3:2016 dhe IEEE 802.1D për protokollet PPR dhe HSR, IEC 61850-4,6,7-1,7-2,7-3,7-4,8-1,10, standardi IEEE C37.238TM-2017 dhe DNP 3.0 ose ekuivalente me to. AK do pranojë edhe mundësinë e paraqitjes së standardeve shqiptare SSH mbi konformitetin e standardit europian dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë **SSH IEC SSH EN**.

*Nuk është paraqitur asnjë dokument për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenit 40 pika 6 gërma (c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Në përmbushje të kriterit të mësipërm Operatorët Ekonomike, duhet të paraqesin dëshmi të testimeve zyrtare të ngjashme për ti krijuar bindjen AK se malli i ofruar është brenda parametrave të kërkuara.

Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të nenit 92 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe referuar kriterëve të pranimit dhe kualifikimit komisioni i vlerësimit të ofertave konkludon se OE: “**NOVAMAT**” shpk me Nr. Nipti **K816150020**...” nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë në përputhje me kriteret e vendosura duke e shpallur ofertë të pavlefshme.

Sa më sipër, referuar nenit 82/2 të VKM nr. 285, 19.05.2021 i ndryshuar, ku parashikohet se: “Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme”, OE: “**NOVAMAT**” Shpk s’kualifikohet për mospërmbushje të kriterëve për kualifikim.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se OE: “**EL-POWER**” shpk me Nr. Nipti **L12009008K** dhe me adresë: Tiranë Nr Pas. 1/220+2-53, ZK nr. 8360, Bulevardi Zogu i Parë, Ndërtesa Nr.6, SH/K 2, Ap.53, se oferta e paraqitur me vlerë totale 271,366,000.00



*(Dyqind e shtatëdhjetë e një milion e treqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë pikë zero) lekë pa TVSH, totali i pikëve të marra (100) është identifikuar si fitues (paraprak) i procedurës së prokurimit.*

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

## **TITULLAR I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**DREJTOR I DREJTORISË SË TENSIONIT TË LARTË OSSH SH.A.**